



NJOFTIMI PËR AFATIN E KËRKESAVE Ndërmarrja Shoqërore Kombinati Xehtaro Metalurgjik Kimik “Trepça”

Në bazë të nenit 17 të ligjit mbi Riorganizimin e Ndërmarrjeve të Caktuara dhe Pasurive të tyre, Ligji Nr. 04/L-035, që ka hyrë në fuqi më 26 tetor 2011 (tani e tutje “Ligji për Riorganizimin”), në lidhje me Vendimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (tani e tutje “Dhoma e Posaçme”) Nr. SCR-05-001-R008, R009 dhe R011, i datës 19.05.2011, dhe Njoftimi për Moratorium i publikuar më 8 nëntor 2011, si dhe Aktvendimi Nr. AC-I-12-0131, Agjencia Kosovare e Privatizimit (tani e tutje “Agjencia”) publikon këtë Njoftim në lidhje me Ndërmarrjen Kombinati Xehtaro Metalurgjik Kimik “Trepça” (tani e tutje “Ndërmarrja”) si ndërmarrje themelore, si dhe ndërmarrjet tjera që identifikohen me kompleksin Trepça:

- A. Efektive nga 8 nëntori 2011, siç specifikohet në Njoftimin e Moratoriumit të publikuar, Agjencia duhet të shërbej si Administrator i ndërmarrjes dhe të gjitha veprimet, procedurat dhe aktet e çfarëdo lloji që synojnë në përcaktimin e vlefshmërisë së, zbatimin ose kënaqjen e çfarëdo kërkesë ose interesi lidhur me ndërmarrjen e përmendur në Njoftimin për Moratorium, ose pasuritë e tyre, janë suspenduar dhe duhet të vazhdojnë vetëm me lejen e Dhomës së Posaçme.
- B. Në përputhje me nenin 17 të Ligjit, Agjencia publikon këtë Njoftim për afatin e dorëzimit të kërkesave që ofron detajet e metodës për parashtrimin e dëshmime të kërkesave dhe dëshmime të interesit, dhe përcaktimin e afatit për parashtrimin e dëshmime të tilla të kërkesës dhe dëshmime të interesit.
- C. Të gjithë personat që pretendojnë se kanë Kërkesa dhe/apo Interesa ndaj Ndërmarrjes apo asetit të saj ftohen t’i parashtrorjnë Dëshmitë e Kërkesave dhe/apo Dëshmitë e Interesit në formën e paraparë ligjore, duke filluar nga 1 nëntor, 2013, deri më 30 dhjetor, 2013, (60 ditë nga dita e njoftimit) në ora 16:00 (koha e Kosovës) pranë Agjencisë në adresën në vijim:

Zyra Qendrore, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. Ilir Konushevcu Nr .8, 10 000 Prishtina, Kosovë

- D. Të gjithë personat që pretendojnë të kenë kërkesa ose interesa ndaj ose kundër Ndërmarrjes ose ndonjë aseti të Ndërmarrjes kërkohet të jenë në përputhje me kushtet e specifikuar në këtë njoftim, pa marr parasysh nëse ata kanë njoftuar më parë Dhomën e Posaçme, Agjencinë apo paraardhësen e Agjencisë – ish Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit.
- E. Kërkesat e paraqitura apo dorëzuara në çfarëdo forme, pas mbylljes së afatit të parë të shpallur sipas njoftimit të datës 01 nëntor 2012, i cili ka mbaruar me 31 dhjetor 2012, respektivisht 04 janar 2013, janë kërkesa të dorëzuara jashtë afatit ligjor dhe si të tilla nuk do të shqyrtohen.
- F. Mos-paraqitja e kërkesave apo pretendimeve për interesat brenda afatit të rishpallur të paraparë për dorëzimin e kërkesës do të refuzohen dhe do të konsiderohet si çështje përgjithmonë të mbyllura nga Administratori, përkatësisht Agjencia.
- G. Formularët standardë të kërkesës dhe udhëzimet për dorëzimin e dëshmisë së kërkesës dhe dëshminë e interesit mund të merren në zyrat e Agjencisë Rr. Ilir Konushevcu Nr.8; 10 000 Prishtina, Kosovë ose të shkarkohen nga faqja zyrtare e internetit e Agjencisë www.pak-ks.org.
- H. Personat apo subjektet e interesuara mund të marrin listën e asetëve të Ndërmarrjes në zyrat e Agjencisë Rr. Ilir Konushevcu Nr. 8; 10 000 Prishtina, Kosovë ose t’a shkarkojnë atë nga faqja zyrtare e internetit e Agjencisë www.pak-ks.org.
- I. Agjencia është përgjegjëse për zhvillimin dhe shpërndarjen e Planit të propozuar për Riorganizimin e Ndërmarrjes.
- J. Kreditorët e Kualifikuar apo Grupi i Kualifikuar i Kreditorëve, të përkufizuar në nenin 2 të Ligjit për Riorganizimin, do të kenë të drejtë të parashtrorjnë një propozim alternativ për riorganizimin e Ndërmarrjes (“Plani Alternativ I Riorganizimit), në pajtim me dispozitat e nenit 22 të këtij ligji.
- K. Të drejtat dhe interesat e kreditorëve janë të mbrojtur sipas Ligjit për Riorganizimin.

Të gjitha kërkesat deponohen në adresën e mëposhtme:

Agjencia Kosovare e Privatizimit/ZQ, Rr. Ilir Konushevcu Nr .8, 10 000 Prishtinë - Kosovë; Tel: + 381 38 500 400; Fax: + 381 38 248 076; E-mail: trepca@pak-ks.org; Faqja e internetit: www.pak-ks.org